

VENDIM
Nr. 448, datë 26.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 673, DATË 22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RIORGANIZIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 5, të kreut II, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në shkronjën "i", fjalët "... sipas listës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi ...", zëvendësohen me "... që janë nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave ...";

ii. në shkronjën "j", fjalët "... për institucionet sipas listës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi..." zëvendësohen me "... për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave ...".

b) Në kreun III bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. në pikën 9 hiqen fjalët "sipas listës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.";

ii. në pikën 12 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga një zëvendësdrejtor.".

c) Pika 18, e kreut IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

"18. Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018.".

ç) Lista nr. 2 bashkëlidhur vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama